



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**BORDI  
VENDIM**

**Nr. 164, Datë 04.11.2019**

**MBI  
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË FURNIZUESI I SHËRBIMIT  
UNIVERSAL SHA (FSHU SHA) NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1, gërma “d”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe të nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 04.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 100/2 Prot, datë 28.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 147, datë 04.10.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sha (“FSHU” sha) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 32/46 Prot, datë 04.10.2019, bëri njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria FSHU sh.a.
- Për këtë shoqëri pritja e komenteve dhe objeksioneve ka qënë 10 ditë pune nga fillimi i procedurës në zbatim të nenit 16, pika 6 të rregullores së licencimit dhe si i tillë ky afat ka përfunduar në datën 17.10.2019, ndërsa afati maksimal për t’u shprehur Bordi për këtë procedurë përfundon në datën 14.11.2019.
- Në shkresën nr. 638 Prot., datë 09.10.2019, ERE dërgoi pranë subjektit “FSHU” sha, njoftimin e vendimit dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim, i cili konsiston si më poshtë:
  - Neni 9, pika 2: gërma “c” (Vërtetimi i rregjistrimit nga QKB).
  - Neni gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Në vijim, aplikuesi me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 638/1, datë 17.10.2019, ka përcjellë dokumentacionin e plotësuar.
- Shoqëria FSHU sha, është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike nr. 251, Seria P14FPP, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014 dhe transferuar me vendimin nr. 215, datë 11.10.2019 të Bordit të ERE.
- Me vendimin e ERE nr. 264, datë 20.12.2019, është përcaktuar një periudhë tranzitore prej 12 muaj për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha (OSHEE sha) tek operatorët e rinj të krijuar prej saj, ku ndër to edhe shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sha (“FSHU) sha.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria FSHU sh.a., në bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike ”*, rezulton si më poshtë vijon:
  - **Neni 16, pika 1, gërma “a”** - Formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gërma “a”; gërma “b”; gërma “c”; gërma “d”- janë plotësuar në mënyre korrekte.
  - **Neni 16, pika 1, gërma “b”**- Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, gërmat “a” dhe “b” gërma “c”; gërma “d”; gërma “e” janë plotësuar në menyrë korrekte .
  - **Neni 16, pika 1, gërma “c”** - Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, gërma “a”; gërma “b”; gërma “c” gërma “d” janë plotësuar në mënyrë korrekte.
  - **Neni 16, pika 1,** - Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike, është plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal “FSHU” sha, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë, për një afat 5 vjeçar, duke filluar vlefshmërinë e saj nga data 21.12.2019.
2. Drejtoria e Licesimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**